



*Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre*

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Tiranë ____ / ____ /2025

Lënda: Rekomandim për trajtimin e rastit të shtetasit z. I. K.

AGJENCISË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

TIRANË

BASHKIA

ELBASAN

Të nderuar,

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit, siç jeni në dijeni, është regjistruar një ankesë nga z. I. K. , ndaj Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC) dhe Bashkisë Elbasan, në të cilën ai parashtroi, ndër të tjera, se më datë 17.12.2013, i është dëmtuar banesa nga rrëshkitja e tokës në fshatin Bixhellë.

Ankuesi shprehet se pasi i është drejtuar AKMC-së më datë 27.10.2022, në të cilën ka marrë përgjigje pozitive, ku i thuhet se disponojnë të gjithë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan për rastin e z. I. K. dhe pasi i kanë vlerësuar ato, do të realizojnë kompensimin për dëmet e shaktuara sipas mundësive financiare dhe akordimit të fondit financiar. Por,

më pas ankuesi citon, se edhe pse ka kaluar një periudhë e gjatë, nuk e ka marrë këtë kompensim.

Pas regjistrimit të kësaj ankese, Institucioni i Avokatit të Popullit ka konstatuar se, ankesa e paraqitur plotëson të gjithë kushtet thelbësore si në aspektin formal, ashtu edhe në atë substancial për t'u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, ndaj bazuar në nenin 13, shkronjën "a", të nenit 17 dhe shkronjën "b", të nenit 18, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar (*ligj nr. 8454/1999*), ka vendosur ta pranojë atë dhe të fillojë procedurën e shqyrtimit të çështjes.

Institucioni i Avokatit të Popullit, i është drejtuar fillimisht AKMC-së me shkresat nr. K3/I20-2 prot., datë 05.05.2023 dhe nr. K3/I20-4 prot., datë 15.09.2023 "Kërkesë e përsëritur për shpjegime", duke i kërkuar informacion e dokumentacion lidhur me sa pretendohet për pamundësinë e dhënies së kompensimit financiar, si dhe mundësitë aktuale dhe përpjekjet nga ana e tyre për të orientuar rastin, duke synuar zgjidhjen e kërkesës së ankuesit.

Me shkresat nr. 182/5 prot., datë 26.01.2023 dhe nr. 734/5 prot., datë 27.10.2022, AKMC ka bërë me dije ankuesin, se, *"...disponon të gjithë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan dhe pas vlerësimit të tyre, bazuar akteve normative në fuqi dhe mundësive financiare do të realizojë kompensimin për dëmet e shkaktuara"*.

Ndërkohë, AKMC në shkresën drejtuar Avokatit të Popullit nr. 182/12 prot., datë 26.09.2023, është shprehur njësoj si përgjigja e kthyer për ankuesin.

Duke patur parasysh interesin më të lartë të qytetarit, me shkresën nr. K3/I20-5 prot., datë 28.09.2023 institucioni i Avokatit të Popullit i është drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (*MFE/MF*), duke i kërkuar të na informonin lidhur me analizën që kanë kryer për fondin e akordimit të kompensimit; arsyet e mosakordimit të fondeve sidomos të rasteve sensitive e emergjente si dhe hapat e ndërmarrë tashmë duke synuar zgjidhjen e kësaj situate.

Me shkresën nr. 17701/1, datë 19.10.2023, MFE është shprehur, ndër të tjera, se për vitin 2023, në zbatim të nenit 15, të ligjit nr. 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", ka miratuar detajimin e fondit në shpenzime korrente të planifikuara për Emergjencat Civile sipas kërkesës së Ministrisë së Mbrojtjes (AKMC-së). Më konkretisht, për Bashkinë Elbasan, për vitin 2023, është akorduar fondi i kushtëzuar prej 33.7 milion lekë në shpenzime, për t'u përdorur sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 414/2021 "Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", të ndryshuar.

MFE në përfundim ka sqaruar se përdorimi i fondit të kushtëzuar në përputhje me kriteret e përcaktuara, mbetet në përgjegjësinë e Bashkisë dhe AKMC-së.

Me shkresën nr. K3/I20-8 Prot., datë 03.09.2024, i jemi drejtuar MF, Bashkisë Elbasan dhe AKMC për koordinimin e tyre institucional me qëllim realizimin e kompensimit financiar të ankuesit.

Me shkresën nr. 11877/1 prot., datë 16.09.2024, MF ka shprehur, ndër të tjera, se në zbatim të përcaktimeve në ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, ka miratuar akordimin e fondit, në programin “Emergjencat Civile” në masën 800 milionë lekë dhe vetëm për Bashkinë Elbasan në fondin 30.9 milionë lekë për t’u përdorur sipas procedurave dhe në zbatim të kriterëve të përcaktuara. Ndërkohë përmes Aktit Normativ nr. 3, datë 28.08.2024, janë akorduar 150 milion lekë shtesë në tavanet e Ministrisë së Mbrojtjes, për programet e Emergjencave Civile. Lidhur me ankuesin, MF shprehet se nuk disponojnë informacion nëse ky ankues është kompensuar ose jo, pasi përdorimi i fondit të kushtëzuar dhe mbajtja e të dhënave analitike është përgjegjësi e Bashkisë dhe AKMC-së.

Bashkia Elbasan, me shkresën nr. 4112/1 prot., datë 17.09.2024, shpreh, ndër të tjera, se janë marrë të gjitha hapat si dhe është ridërguar e pranuar i gjithë dokumentacioni lidhur me këtë ankues pranë AKMC-së. Po ashtu, janë shprehur se: *“me shkresën nr. 1219/2 datë 11.07.2024 AKMC-ja ka kthyer një përgjigje Bashkisë Elbasan, se dosja është e plotë dhe do të realizojë akordimin e fondit përkatës sipas mundësive financiare. Deri në përgjigjen përfundimtare të Agjencisë, nuk mund të bëhej likuidimi financiar për dëmet e objektit në fjalë... ,ndërkohë ankuesit i ka kaluar në llogarinë e tij bankare fondi, shpërndarë nga fondi i Mbrojtjes Civile për vitin 2024”*.

Me shkresën nr. 1612/1 prot., datë 16.09.2024, AKMC-ja është shprehur, ndër të tjera, se: *“...Pas konfirmimit nga ana e Bashkisë Elbasan për kompensimin e vlerës së mbetur financiare dhe me qëllim zgjidhjen e problematikës së përsëritur për rastin e z. I. K. , pritët të realizohet praktika e plotë për kompensimin financiar”*.

Duke qenë se ankuesit nuk ishte kompensuar ende me vlerën e plotë të dëmshpërblimit, me shkresat nr. K3/I20-13, datë 12.11.2024 dhe nr. K3/I20-14, datë 13.12.2024, kemi kërkuar AKMC-së dhe Bashkisë Elbasan, të na informonin nëse ishte realizuar apo jo tashmë kompensimi i plotë; nëse jo, arsyet konkrete; cili ishte afati i mundshëm për realizimin e kompensimit të plotë dhe hapat që do të ndërmerrenit për realizimin e menjëhershëm të përfundimit të praktikës dhe dhënies së ndihmës së plotë financiare.

Me shkresën nr. 1612/6 prot., datë 05.12.2024 AKMC është shprehur, ndër të tjera, se pas vlerësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor, sipas komunikimit shkresor nr. 1748/5 prot., datë 17.10.2024 “Njoftim për dhënie fondi financiar familjeve, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme”, drejtuar Bashkisë Elbasan, ka gjeneruar shumën e kompensimit, e cila përmbush të gjithë detyrimin financiar ndaj shtetasit I. K. dhe se detyrimi i tyre financiar ndaj shtetasit I. K. është përmbushur.

Me shkresën nr. 5601/1 prot., datë 13.12.2024 Bashkia Elbasan shpreh, ndër të tjera, se ankuesit i kanë kaluar përveç fondit xxxxx lekë, edhe një fond që ka kaluar zyrtarisht nga AKMC, prej xxxxx lekë, veprim i kryer/vërtetuar me urdhër-shpenzimin nr. 1032, datë 12.11.2024. Sipas Bashkisë nga fondi total të cilit i takon z. I. K. prej xxxx lekë, tashmë ka mbetur për t’iu likuiduar edhe shuma prej xxxx lekë, fond i cili sigurisht do të vijë nga AKMC në të njëjtën formë sikurse erdhi fondi i fundit (prej xxxxx lekë, i cilësuar edhe në formë tabelare të shpërndarjes).

Por, nga ana tjetër, me shkresën nr. 1612/10 prot., datë 23.12.2024 AKMC ka shprehur, ndër të tjera, se *“AKMC bazuar në VKM...ka realizuar vlerësimin total të dokumentacionit tekniko-ligjor për I. K. dhe në bazë të analizës së elementëve të dokumentacionit, si dhe konfirmimit nga Bashkia Elbasan për kompensimin e vlerës së mbetur financiare, ka komunikuar masën e kompensimit financiar, duke përmbushur të plotë detyrimin ndaj rastit në fjalë ...Në lidhje me pretendimet e përcjella në mënyrë të vazhdueshme mund t’i drejtoheni Bashkisë Elbasan...”*.

Po ashtu, nga informacioni i marrë nga Bashkia Elbasan është konfirmuar që vendimi i kompensimit është me nr. 20, datë 23.06.2014, i marrë nga Këshilli Bashkiak Elbasan.

Sa më sipër, duke vlerësuar përpjekjet nga ana juaj për akordimin e një pjese të fondit kompensues në favor të ankuesit në fund të vitit 2024, konstatohet se ende një pjesë e kompensimit financiar ndaj ankuesit nuk është realizuar ende.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile është një nga autoritetet e mbrojtjes civile, e cila si një institucion dhe strukturë qendrore ushtron përgjegjësinë e saj në drejtim të planifikimit të fondeve dhe masën e miratuar të kompensimit, por edhe rehabilituese ndaj fatkeqësive.

Vlerësojmë se lidhur me rastin në fjalë, veprimtaria administrative e kryer nga institucionet kompetente nuk ka qenë efikase dhe nuk i është përgjigjur situatës emergjente, si pasojë e së cilës ka rezultuar se deri më sot akoma nuk është zgjidhur tërësisht problematika e ankuesit I. K. , për shkak të

mosakordimit të plotë të fondit për ndihmë financiare, në favor të këtij shtetasi.

Konkretisht, sikurse rezulton nga hetimi administrativ në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak Elbasan nr. 20, datë 23.06.2014, ndaj ankuesit është realizuar akordimi dhe dhënia e kompensimit¹ jo e plotë.

Deri më sot nuk është mundësuar akordimi i plotë i ndihmës financiare për këtë shtetas, pasi ende nuk ka përfituar shumën e plotë për dëmet e shkaktuara në banesën e tij.

Sikurse rezultoi nga hetimi administrativ, AKMC-ja pavarësisht se shprehet që dokumentacioni i ankuesit ka qenë i hartuar dhe i plotësuar në përputhje me ligjin, nuk është arritur ende në përmbylljen e praktikës për kompensimin e plotë të ankuesit, edhe pse kanë kaluar më shumë se 11 vite që nga momenti i ndodhjes së fatkeqësisë natyrore (duke e lënë ankuesin pa një banesë si një e drejtë bazike e qytetarit). Në kushtet kur kjo panoramë dokumentare ka qenë e plotë, nga ana e autoritetit kompetent shtetëror është vijuar më tej me kompensimin financiar për këtë shtetas në mënyrë jo të plotë, sikurse vetë pohohet edhe nga ana e Bashkisë Elbasan (pasi nuk ka ardhur fondi i plotë nga ana e AKMC, por një pjesë e saj).

Edhe sikur në mënyrë hipotetike të pranonim për një çast qëndrimin e mbajtur të sipërcituar, konstatojmë se, veprimet e ndërmara nuk i përgjigjen situatës sikundër parashtrohet, pasi përgjatë gjithë kësaj kohe nuk ka patur asnjë akt administrativ i cili do të përfundonte procedurën administrative lidhur me zgjidhjen e rastit të ankuesit.

Në përputhje me pikën 2, të nenit 15, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Bazuar në legjislacionin për dëmshpërblimin financiar për rastet e fatkeqësisë natyrore, konkretisht ligji nr. 8756, datë 26.3.2001 “*Për emergjencat civile*”, i ndryshuar, dhe VKM-në nr. 329, datë 16.05.2012 “*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerësore*” (VKM nr. 329/2012), vlerësojmë

¹ Në shumat xxx lekë (shpërndarë nga fondi i Mbrojtjes Civile) dhe xxxx lekë (nga AMKC-ja). Nga fondi total të cilit i takon z. I. K. prej xxxx lekë, tashmë ka mbetur për t’iu likuiduar shuma prej xxxx lekë, fond i cili sipas Bashkisë Elbasan duhet t’i dërgohet Bashkisë Elbasan nga AKMC-ja, në të njëjtën formë sikurse erdhi fondi i fundit (referuar këtu shkresës nr. 5601/1 prot. datë 13.12.2024. Ndërkohë, vetë AKMC ka shprehur në shkresa të përsëritura se ajo e ka përmbushur të plotë detyrimin financiar ndaj ankuesit (shkresat më të fundit nr. 1612/6 prot., datë 05.12.2024 dhe nr. 1612/10 prot., datë 23.12.2024 të AKMC-së).

se, institucionet përkatëse ende nuk kanë plotësuar detyrimin për kompensimin e plotë të ankuesit.

Ndërsa vlerësojmë se, në ushtrim të funksioneve të institucioneve dhe në përmbushje të përgjegjësi të parashikuara në ligj, gjatë veprimtarisë administrative lidhur me rastin, rezulton mosveprim i pjesshëm lidhur me kompensimin e plotë, në ushtrimin e kompetencave detyruese ligjore, e për pasojë janë kryer veprime ose mosveprime që bien ndesh me frymën e parimeve të Kodit të Procedures Administrative, e konkretisht konstatojmë se:

Është cenuar parimi i ligjshmërisë, i cili parashikohet në nenin 4, të Kodit të Procedurës Administrative, ku parashikohet se: *“Organet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca”.*

Parimi i drejtësisë dhe i paanësisë, i cili parashikohet në nenin 13, të Kodit të Procedurës Administrative ku parashikohet se: *“Në ushtrimin e funksioneve të tij, organi publik trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjektet me të cilat krijon marrëdhënie”*, pasi nga ankesa të tjera të trajtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit rezulton se janë kompensuar raste të mëvonshme, për fatkeqësi natyrore pas vitit 2013.

Parimi i objektivitetit, i cili sanksionohet në nenin 14, të Kodit të Procedurës Administrative ku parashikohet se: *“Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe i japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative.”*

Parimi i deburokratizimit dhe i efijencës, i cili parashikohet në nenin 18, paragrafi 2, i Kodit të Procedurës Administrative parashikon se: *“Procedura administrative zhvillohet sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se afati kohor i parashikuar me ligj për të, me sa më pak kosto për organin publik dhe për palët, në mënyrë që të arrihet çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm”.*

Evidentojmë faktin se gjatë hetimit administrativ lidhur me rastin ka rezultuar se ka patur veprime apo mosveprime nga ana e institucioneve, të cilat nuk kanë qenë në korrelacion me kryerjen e detyrave funksionale dhe në përputhje me kompetencat e këtij organi, sikurse janë të përcaktuara me ligj, me akt nënligjor, si dhe veprimet administrative të nxjerra në zbatim të tyre,

ushtrimi i të cilave është i detyrueshëm² për të. Më konkretisht nuk është akorduar plotësisht kompensimi në favor të ankuesit për fatkeqësinë e ndodhur në vitin 2013, për më tepër kur bëhet fjalë për banesë, si një nevojë bazike jetike për familjen e ankuesit.

Gjatë trajtimit të kësaj çështjeje është me vend të sjellim në vëmendje, parimin e përgjegjësisë në veprimtarinë e organeve publike të parashikuar në nenin 15, të Kodit të Procedurave Administrative, ku parashikohet shprehimisht se: *“Organet publike dhe nëpunësit e tyre, kur kryejnë një procedurë administrative, mbajnë përgjegjësi për dëmet që u shkaktajnë palëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi”*.

Mosveprimi në këtë kuptim, vendos institucionet në kushtet e parashikuara në ligjin nr. 8510 datë 15.07.1999, *“Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike”*, të ndryshuar, (ligji nr.8510/1999), pasi realisht ankuesit ende vijon t’i jetë shkaktuar një dëm pasuror, në kushtet e trajtimit jo në përputhje me parashikimet ligjore të kësaj çështjeje. Në kuptim të përgjegjësisë jashtëkontraktore, si një detyrim i organeve të administratës shtetërore, për të shpërblyer dëmin që i është shkaktuar interesave të ankuesit si person privat, në ushtrim e sipër të funksioneve tuaja publike, rasti në fjalë parashikohet në nenin 3, paragrafi “a”, të ligjit nr. 8510/1999, ku parashikohet se: *“Organet e administratës shtetërore përgjigjen për dëmet që u shkaktajnë personave fizikë a juridikë private, në rastet që vijnë, ... - Kur kryejnë veprime a mosveprime të kundërligjshme”*. Pas përfundimit të procedurës për fatkeqësinë e ndodhur në vitin 2013, pas verifikimit të dokumentacionit, rezulton se nuk është dhënë i plotë kompensimi financiar, për këtë fatkeqësi të ndodhur mbi 11 vite më parë, e cila i ka kushtuar shumë ankuesit në shumë aspekte.

Kujtojmë se, organet e administratës shtetërore janë të detyruara që qytetarëve t’u sigurojnë, realizim të drejtë dhe efikas të të drejtave, lirive kushtetuese e ligjore, si dhe interesave të tyre të ligjshme gjatë një procedure administrative. Në ushtrimin e veprimtarisë, institucionet shtetërore duhet të udhëhiqen nga parimi i ligjshmërisë dhe përgjegjshmërisë në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara. Kjo pasi çdo organ administrativ duhet ta mbështesë veprimtarinë e tij administrative tek parashikimet ligjore e nënligjore, si dhe të përgjigjet për veprimet e tij tek autoritete të tjerë administrativë, legjislativë ose juridikë. Përgjegjshmëri do të thotë gjithashtu që asnjë autoritet nuk duhet të përjashtohet nga hetimi, duke përfshirë hetim nga gjykatat, ankim tek një organ administrativ më i lartë, investigim nga Avokati i Popullit, inspektim nga një bord ose komision special dhe hetim nga një komision parlamentar. Përgjegjshmëria është një instrument që tregon nëse respektohen parimet e ligjshmërisë, të qenit i hapur, parimi i transparencës, parimi i paanësisë dhe barazisë para ligjit. Përgjegjshmëria

² Neni 22/2 i Kodit të Procedurës Administrative.

është esenciale për të siguruar vlera si efienca, efektiviteti, besueshmëria dhe parashikueshmëria e administratës publike.

Mbi këtë bazë dhe në përputhje me parashikimet e bëra në nenet 5 dhe 8, të ligjit nr. 8510/1999, organet publike, duhet tashmë që të fillonin një procedurë administrative për njohjen e demit që i keni shkaktuar z. I. K. , duke marrë për bazë edhe dispozitat respektive të Kodit Civil, për shkaktimin e demit, si dhe nxjerrjen e përgjegjësiwe përkatëse.

Avokati i Popullit është një organ që kryen një rregullim institucional të shtetit të së drejtës duke kryer dhe promovuar standartet e një procesi të rregullt ligjor i shtrirë ky te tre pushtet: legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Avokati i Popullit si mekanizëm i shtetit të së drejtës me kompetenca fleksibël ndihmon në ruajtjen e themeleve të këtij të fundit dhe se Avokati i Popullit gjithashtu luan një rol thelbësor në sigurimin e mirëqeverisjes. Përmes pavarësisë dhe paanshmërisë së tij, institucioni i Avokatit të Popullit është një faktor i rëndësishëm në qeverisjen publike, veçanërisht sot kur funksionet e institucioneve të Avokatit të Popullit janë zgjeruar në lidhje me keqadministrimin dhe sundimin e ligjit.

Në këtë këndvështrim, duam t'iu kujtojmë përkufizimin tashmë të pranuar nga Parlamenti Europian, në lidhje me keqadministrimin nga ana e organeve të administratës publike, sipas të cilit: *“Keqadministrimi ndodh kur një organ publik, nuk vepron në përputhje me një rregull apo princip, i cili është i detyrueshëm për të”*. Në këtë aspekt, theksojmë se prej më shumë se 11 vitesh, ankuesit nuk i është dhënë kompensimi i plotë, problematikë e ankuesit e cila vijon ende.

Referuar rastit në hetim, nuk rezulton që institucionet të kenë zbatuar detyrimet ligjore në kuadër të sigurimit të një procesi të rregullt ligjor.

Detyrimi për një proces të rregullt ligjor buron edhe nga mekanizmat ndërkombëtarë, si Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (neni 6 i saj), i cili kërkon detyrimisht aplikim rigoroz nga instrumentat e brendshëm të një shteti.

Në respektim të këtij parashikimi, e drejta për një proces të rregullt ligjor është ngritur në nivel Kushtetues. Konkretisht neni 42, pika 1, e Kushtetutës, parashikon se: *“Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor”*, ndërsa neni 15, pika 2, e Kushtetutës parashikon se: *“Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre”*.

Në analizë të parashikimeve Kushtetuese rezulton se ankuesi, për shkaqe të pavarura nga ai, nuk ka marrë një vendim përfundimtar në një procedurë administrative, në një kohë që ka respektuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni përkatës, e për rrjedhojë ai nuk i gëzon të drejtat që i garanton legjislacioni në fuqi. Institucioni ynë vlerëson se vonesa në trajtimin e plotë të praktikës së shtetasit z. I. K. , kufizon liritë dhe të drejtat e tij të garantuara nga Kushtetuta dhe ligji, e më konkretisht, të drejtën e pronësisë.

Një tjetër çështje që sjellim në vëmendje për shkak të zgjatjes së procedurës administrative është cënimi i parimit të sigurisë juridike.

Siguria juridike nënkupton, veç të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Organet e administratës nuk mund të përkeqësojnë në mënyrë të paarsyeshme gjendjen ligjore të personave, të mohojnë të drejtat e fituara ose të shpërfillin interesat legjitime të tyre.

Besimi që ka qytetari në situatën e favorshme ligjore paraqitet i rëndësishëm jo vetëm për t'u mbrojtur nga normat dhe parimet kushtetuese por edhe nga veprimtaria e administratës gjatë veprimtarisë së saj, e cila duhet të garantojë ligjshmërinë e veprimeve që shteti kryen me qytetarët e tij, sigurinë juridike se qytetari është objekt i veprimeve të ligjshme dhe se institucionet shtetërore do i garantojnë të drejtat dhe liritë themelore të tij.

Shkelja e të drejtave të mësipërme, sjell në marrëdhënie me shtetasit një sërë problematikash, duke filluar që nga humbja e besimit të qytetarëve tek organet e administratës publike, e deri tek rreziku i përballjes së organeve të administratës me padi civile për dëm jashtëkontrator, që mund t'i jetë shkaktuar shtetasve, nga shkelja e të drejtave të sipërpërmendura.

Organet e administratës publike duhet të bëjnë përpjekjet maksimale për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor e në përputhje me nenin 6/1 të KEDNJ-së. Kjo procedurë, nuk është përfunduar në mënyrë të rregullt ende deri më sot.

Bazuar në nenin 63, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga administrata publike”*, si dhe nenin 21, shkronja “b”, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, në të cilin parashikohet se: *“Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit kryen këto veprime..., b) paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”, c) Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje*

masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”;

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave për akordimin e vlerës së pashlyer të ndihmës financiare për shtetasin I. K. , për dëmtimin e banesës nga fatkeqësia natyrore e datës 17.12.2013.
2. Marrjen e masave lidhur me nxjerrjen e përgjegjësive dhe evidentimin e personave që kanë çuar në cenimin e së drejtës së ankuesit duke mos përfunduar procedurën administrative për dhënien e plotë të ndihmës financiare për shtetasin I. K. .
3. Marrjen e masave administrative dhe ligjore për mospërsëritjen e situatave të tilla në të ardhmen, pra të mosveprimit të duhur të institucioneve tuaja, duke mos respektuar procedurat ligjore dhe të drejtat e shtetasve.
4. Shpërblimin e plotë të dëmit të shkaktuar ankuesit sipas parashikimeve e vlerës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Në zbatim të nenit 22, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, brenda 30 ditësh nga marrja e këtij rekomandimi lutemi të na vini në dijeni mbi qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi si dhe masat e marra për rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

K O M I S I O N E R E

ERINDA MELI